# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-435326**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Në prag të vitit të ri shkollor, Bashkia e Tiranës masa të shtuara për institucionet arsimore! Në fokus garantimi i procesit të rregullt mësimor - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sociale/ne-prag-te-vitit-te-ri-shkollor-bashkia-e-tiranes-masa-te-shtuara-per-in-i585224` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 15:39:54 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 16:15:31 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `72cc46a862b787106fef44d7cdbdba956849f6289cf9099be878e5802f713349` |
| TEKSTI | `1b8131851c3491d6048c775e8c7582e4b56646fefe120aeebd0affb1f713228b` |
| PAMJA | `185fb235d0695e9a1634baa985cbbf666abc9a78e5ee34f66255fb034972d635` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `be2bcd1f4f93c8534ef2633fb7d46cccc78014ed5d8d6a1e55d4e7d3a4695e11` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/be2bcd1f4f93c8534ef2633fb7d46cccc78014ed5d8d6a1e55d4e7d3a4695e11`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Në prag të vitit të ri shkollor, Bashkia e Tiranës masa të shtuara për institucionet arsimore! Në fokus garantimi i procesit të rregullt mësimor - Shqiptarja.com

10 Shtator 2026, 18:15Sociale TEMA

Në prag të vitit të ri shkollor, Bashkia e Tiranës masa

Në prag të nisjes së vitit të ri shkollor 2026–2027, Bashkia e Tiranës ka njoftuar se ka marrë një sërë masash për të garantuar fillimin e rregullt dhe të sigurt të procesit mësimor në institucionet arsimore të kryeqytetit.

Përmes një urdhri të Bashkisë së Tiranës ngarkohen institucionet vartëse të saj të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë veprimet me institucionet arsimore, Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe strukturat e tjera përgjegjëse me qëllim zgjidhjen në kohë të çdo nevoje.

Një nga pikat kryesore të urdhrit lidhet me gjendjen dhe mirëmbajtjen e shkollave. Strukturat përgjegjëse duhet të verifikojnë gjendjen fizike të godinave, përfshirë çatitë, dritaret, dyert, shkallët, korridoret dhe ambientet e përbashkëta, si dhe funksionimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe pastrimit, ku kërkohet furnizimi me materiale higjieno-sanitare dhe mirëmbajtjen periodike të klasave, korridoreve, ambienteve sanitare dhe oborreve.

Masa të posaçme sipas Bashkisë parashikohen edhe për sigurinë e nxënësve, veçanërisht pranë shkollave që ndodhen në zona me qarkullim të lartë. Strukturat përgjegjëse duhet të verifikojnë sinjalistikën rrugore, vijëzimet, ndriçimin dhe elementet e tjera të sigurisë pranë institucioneve arsimore, ndërsa parashikohen kontrolle periodike për garantimin e rendit dhe parandalimin e situatave që mund të cenojnë mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Në urdhër përfshihen edhe masa për gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e oborreve të shkollave, kontrollin e pemëve dhe bimësisë, si dhe eliminimin e çdo rreziku të mundshëm për nxënësit.

Një tjetër pikë lidhet me transportin dhe aksesueshmërinë, ku kërkohet kontrolli i funksionimit të transportit shkollor dhe i rrugëve të aksesit drejt shkollave. Për zonat rurale ose të vështira për t'u aksesuar, parashikohen masa të posaçme për garantimin e transportit të sigurt të nxënësve.

Bashkia kërkon gjithashtu bashkëpunim me institucionet arsimore për identifikimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë, parandalimin e braktisjes shkollore dhe mbështetjen e rasteve që kanë nevojë për trajtim social.

Në fokus janë edhe masat kundër zjarrit dhe emergjencave, furnizimi normal me ujë dhe energji elektrike, si dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm mes drejtuesve të shkollave dhe strukturave të Bashkisë.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

Emri

POSTOJE KOMENTIN

[Fermeri shqiptar prodhon speca të kuq me helme, Kroacia gropos 14.7 tonë]

17:35 Sociale

[Papunësia zbret në 8.3 përqind - INSTAT: Shërbimet udhëheqin punësimin, tkurret për bujqësinë]

16:35 Sociale / 1 koment

[118 milionë euro për Durrësin - BE dhe Franca financojnë rehabilitimin e kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura]

13:15 Sociale / 2 komente

[“Afterschool”, falas nga 1 tetori! Lista, cilat janë 85 shkollat e Tiranës?]

10:55 Sociale / 2 komente

[Legalizimet mbyllen në 2028 / Përgjigje për legalizimet, brenda 30 ditëve. Shkrihen Kadastra dhe Agjencia e Pronave]

18:50 Sociale / 7 komente

[Dëmshpërblimet nga zjarret, duhet dokumentacion për tokën dhe të mbjellat]

16:50 Sociale / 1 koment

[Kurrikula Europiane dhe punësimi i sigurt rrisin me 60% interesin për KPGJT]

12:08 Sociale

[Gjetjet e PISA/ Nxënësit shqiptarë kuriozë dhe të angazhuar, Kumbaro në panelin ministror të PISA: Duam më shumë hapësira ku fëmijët mund të shkëlqejnë]

10:25 Sociale / 5 komente

[Rama për rezultatet e PISA-s: Shqipëria mori një “dëftesë të jashtëzakonshme”, rezultati më i mirë ndonjëherë]

08:45 Sociale / 49 komente

[Grant Performance, ministri Demo: 2.5 milionë euro për bashkitë që ofrojnë shërbime më të mira]

20:20 Sociale / 4 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**Republika popullore e protestës**

15:20 Editorial / 119 komente

**“A nuk ju vjen turp?” - Rama u përgjigjet Demokratëve Eur...**

11:53 Politika / 101 komente

**Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-...**

14:50 Kronika / 19 komente

**U pretendua se aktivistja u arrestua pas denoncimit të sa...**

15:13 Politika / 74 komente

**Liderja e AfD: Gjermania duhet të kufizojë pagesat ndaj B...**

13:40 Bota / 41 komente

## Blog Tema

**Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë**

17:05 Blog

**Përse do të jetë “fair” që Erion Veliaj të lirohet**

12:38 Blog / 13 komente

**Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?**

10:25 Blog / 21 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.